

# PËRGJEGJËSIA E PËRDORIMIT TË INTELIJENCËS ARTIFICIALE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

**DOKUMENT  
POLITIKASH**



Ky dokument u prodhuan si pjesë e inisiativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve synon të sigurojë një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja.

**Përgatiti:**

**Andrea MAZELLIU  
Frida MAVRIQI  
Iris ALIAJ  
Lediona DALIPAJ**

Mohim përgjegjësie: Qëndrimet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument politikash (policy paper) i përkasin vetëm autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar ose opinionet e Akademisë së Studimeve Politike dhe Këshillit të Evropës.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij. Autorët e këtij punimi janë të listuar në rend alfabetik.

**Citimi i propozuar:** Mazelliu, A., Mavriqi, F., Aliaj, I., & Dalipaj, L., (2026). Përgjegjësia e Përdorimit të Inteligjencës Artificiale në Ofrimin e Shërbimeve Publike: Rasti i Shqipërisë. *Akademia e Studimeve Politike*

## **Shkurtesa dhe akronime**

IA	Inteligjenca Artificiale
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
BE	Bashkimi Evropian
KiE	Këshilli i Evropës
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimeve

# PËRMBAJTJA

Shkurtesa dhe akronime.....	3
<b>I. Hyrje.....</b>	<b>5</b>
<b>II. Standardet ndërkombëtare mbi administrimin e sistemeve inteligjente dhe detyrimet e shtetit shqiptar .....</b>	<b>7</b>
<b>III. Përgjegjësia e vendimarrjes automatike.....</b>	<b>9</b>
<b>1. Kuadri ligjor shqiptar dhe vendimarrja automatike .....</b>	<b>9</b>
<b>IV. Kufizimet ligjore të përdorimit të inteligjencës artificiale .....</b>	<b>12</b>
<b>1. Sektorët e prekur nga automatizimi algoritmik dhe teknologjia .....</b>	<b>12</b>
<b>2. Transparenca dhe llogaridhënia administrative.....</b>	<b>14</b>
<b>V. Konkluzione dhe Rekomandime.....</b>	<b>16</b>
<b>Bibliografia .....</b>	<b>18</b>

## I. Hyrje

Inteligjenca Artificiale po zhvillohet me ritme shumë të shpejta në mbarë botën dhe po transformon mënyrën se si funksionojnë institucionet publike, ekonomia dhe shoqëria në tërësi. Sistemet e Inteligjencës Artificiale (IA) kanë marrë një vëmendje të konsiderueshme, sidomos në përdorimin e gjerë nga publiku apo administrata publike si një nga mënyrat kryesore të ofrimit të shërbimeve. Sistemet e IA-së po përdoren gjërisht nga qeveritë dhe sektori privat në industri, të cilat janë sensitive si sektori civil, shëndetësia, arsimi, drejtësia, punësimi etj. Inteligjenca Artificiale po përdoret gjithnjë e më shumë për automatizimin e proceseve administrative, analizën e të dhënave në shkallë të gjerë, përmirësimin e shërbimeve publike dhe mbështetjen e vendimmarrjes institucionale. Në shërbimet publike, inteligjenca artificiale mund të ndihmojë në reduktimin e burokracisë, në përshpejtimin e procedurave, në identifikimin e rasteve të korrupsionit, në planifikimin më të mirë të politikave publike dhe në ofrimin e shërbimeve më të personalizuar për qytetarët. Megjithatë, zhvillimi i saj sjell edhe sfida të rëndësishme, si mbrojtja e të dhënave personale, rreziku i diskriminimit algoritmik, mungesa e transparencës në vendimmarrjen automatike dhe nevoja për korniza të qarta ligjore dhe etike. Për këtë arsye, shumë vende po punojnë për të ndërtuar strategji dhe legjislacion të posaçëm për inteligjencën artificiale, me qëllim që të përfitojnë nga potenciali i saj, duke garantuar njëkohësisht respektimin e të drejtave të njeriut dhe parimeve të shtetit të së drejtës.

Në dekadën e fundit, edhe shteti shqiptar ka ndërmarrë politika që lidhen me digjitalizimin e shërbimeve në sektorë të ndryshëm, por Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk parashikon dispozita të qarta për përgjegjësinë në ofrimin e këtyre shërbimeve. Gjithashtu, legjislacioni detyron organet publike të garantojnë respektimin dhe zbatimin e dispozitave që rregullojnë përgjegjësinë e organit publik duke parashikuar kufizime në lidhje me funksionimin dhe ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet sistemeve inteligjente. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, qasja në shërbimet publike në Shqipëri është transformuar rrënjësisht nga një sistem i ndërveprimit fizik ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve që marrin shërbime publike, në një qasje të diversifikuar që lidh elementë të ndërveprimit të drejtpërdrejtë dhe digjital përmes një platforme unike qeveritare (e-albania). Aktualisht, në vendin tonë në rang kombëtar portali qeveritar e-albania ofron 1271 shërbime elektronike, por nuk garanton të dhëna për shërbimet e ofruara nëpërmjet ndonjë sistemi të IA-së.<sup>1</sup>

Ofrimi i shërbimeve me anë të sistemeve inteligjente në Shqipëri është parashikuar edhe në Strategjinë ndërsektoriale “Agjenda digjitale e Shqipërisë” 2022–2026.<sup>2</sup> Strategjia synon integrimin e teknologjive të avancuara në ofrimin e shërbimeve publike dhe përmirësimin e transparencës qeveritare.<sup>3</sup> Inteligjenca artificiale shihet si një instrument për të automatizuar

---

<sup>1</sup> <https://e-albania.al/Pages/Statistics/statistika.pdf>

<sup>2</sup> Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2022, 1 qershor). *Vendim nr. 370, datë 1.06.2026* “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe të Planit të Veprimit 2022–2026.”

<sup>3</sup> ibid

proceset administrative dhe për të përmirësuar analizën e të dhënave publike. Megjithatë, shteti shqiptar nuk ka miratuar ende një ‘Strategji Kombëtare për Inteligjencën Artificiale’ dhe një kuadër ligjor specifik, që rregullon përdorimin e sistemeve të IA-së.. Aktualisht, Strategjia Kombëtare e Inteligjencës Artificiale mbetet ende një ‘projektvendim’ i cili kaloi nëpërmjet një konsultimi publik vetëm procedural pa pasur asnjë koment nga subjektet e interesuara në platformën e konsultimit publik.<sup>4</sup>

Studimet eidentojnë se, një nga problematikat më të rëndësishme që shpesh këto sisteme inteligjente prodhojnë lidhet me ligjshmërinë, rregullimin dhe ndikimin e tyre sidomos në cënimin e të drejtave apo përgjegjësisë administrative që një sistem IA mund të ketë. Një problematikë tjetër konsiston në pengesat ligjore të mosdelegimit të detyrave, apo funksioneve të punonjësve të administratës publike tek sistemet e automatizuara apo të inteligjencës artificiale. Bazuar në parimet të cilat drejtojnë procesin e vendimmarrjes administrative, vlen të theksohet se një nga sfidat kryesore të përdorimit të këtyre sistemeve lidhet me mbikqyrjen dhe kontrollin efektiv njerëzor gjatë procesit të vendimmarrjes.<sup>5</sup> Shtetet me kuadër të plotë rregullator si edhe organizatat ndërkombëtare me fokus standardizimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut kanë ndërmarrë hapa konkrete për të vendosur standarde në rregullimin, përdorimin dhe ofrimin e shërbimeve nëpërmjet sistemeve të IA-së me fokus mitigimin e rrisqeve dhe pasojave.<sup>6</sup>

Ky dokument politikash paraqet një analizë të legjislacionit shqiptar dhe nevojën për një sistem rregullator të unifikuar dhe të përafruar me *acquis* të BE-së me qëllim garantimin e parimeve të shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përdorimin e sistemeve të Inteligjencës Artificiale. Punimi synon të analizojë përgjegjësitë ligjore dhe institucionale që lidhen me përdorimin e inteligjencës artificiale (IA) në ofrimin e shërbimeve publike në Shqipëri. Qëllimi kryesor është të:

- Të analizojë problematikat e evidentuara nga ofrimi i shërbimeve nëpërmjet sistemeve të inteligjencës artificiale
- Evidentojë boshllëqet ekzistuese në legjislacionin shqiptar dhe praktikën institucionale në lidhje me kontrollin dhe përgjegjësinë për përdorimin e teknologjive të avancuara.
- Sugjerojë masa konkrete për të garantuar që përdorimi i IA në administratën publike të jetë në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës, standardet evropiane dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

---

<sup>4</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/864>

<sup>5</sup> Charlotte Langer, “Decision-making power and responsibility in an automated administration” (2024) *Discov Artif Intell* 4, 59, available at <https://doi.org/10.1007/s44163-024-00152-1>, accessed 1 September 2024.

<sup>6</sup> Cani, E. M., & Mazelliu, A. (2025). Navigating the Algorithmic Shift and the Legal Implications of Artificial Intelligence in Albania's Public Administration. *Italian J. Pub. L.*, 17, 496.

## II. Standardet ndërkombëtare mbi administrimin e sistemeve inteligjente dhe detyrimet e shtetit shqiptar

Organizata ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës, OECD dhe Bashkimi Evropian kanë adresuar përdorimin e sistemeve IA si në sferën publike, ashtu edhe në atë private, duke vendosur standardet minimale të mbrojtjes nga dëmi i parikuperueshëm nga këto sisteme. Në vitin 2024, Këshilli i Evropës miratoi Konventën Kuadër për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës, traktati i parë ndërkombëtar detyrues në këtë fushë. Konventa kërkon që përdorimi i IA-së të jetë në përputhshmëri me të drejtat themelore, duke garantuar parimet e mosdiskriminimit, privatësisë dhe të parashikuarjve mjete efektive juridike për qytetarët që ndikohen apo janë viktimë të vendimeve të padrejta të automatizuara.<sup>7</sup> Shqipëria ende nuk e ka nënshkruar dhe apo ratifikuar këtë Konventë, duke krijuar një boshllëk të rëndësishëm në përputhshmërinë e saj me standardet evropiane. Gjithashtu, Konventa parashikon standardet minimale të përdorimit të sistemeve të IA-së, që ndër të tjera lidhen me përgjegjësinë dhe garancitë procedurale dhe detyrimin për të informuar përdoruesit se po bashkëveprohet me një sistem IA-je dhe jo me një qenie njerëzore.<sup>8</sup> Ky rregullim parashikohet edhe në nenin 86 të Aktit Evropian të IA-së i cili do të trajtohet më poshtë ku qytetarët duhet të kenë të drejtën e shpjegimit nëse një vendim administrativ është marrë nga një IA. Konventa parashikon përdorimin e sistemeve të IA-së nga autoritetet publike, duke përfshirë aktorët privatë që veprojnë në emër ose për llogari të tyre, duke vendosur detyrimin që këto aktivitete të respektojnë të drejtën ndërkombëtare, institucionet dhe proceset demokratike.

Konventa kuadër e KiE-së shkon përtej Aktit të BE-së duke e lidhur përdorimin e IA-së me vlerat demokratike dhe rendin kushtetues, një aspekt jetik për vendet në tranzicion demokratik si Shqipëria, ku rreziku i përdorimit arbitrar të teknologjisë është më i lartë. Përveç konventës, një akt tjetër me rëndësi i përmendur më sipër, Akti Evropian i Inteligjencës Artificiale, ofron një model të avancuar për qeverisjen e IA-së në nivel ndërkombëtar. Për shembull, përdorimi i IA-së për përzgjedhjen e përfituesve të ndihmës ekonomike apo vlerësimin e kredibilitetit të tatimpaguesve do të konsiderohet një sistem me rrezik të lartë dhe kërkon auditim të detyrueshëm etik dhe teknik për të garantuar përputhshmërinë me standardet e sigurisë, transparencës dhe të drejtave themelore. Ky klasifikim është bërë nga metodologjia e përdorimit të sistemeve të IA-së në Shqipëri, por dokumenti në fjalë mbetet vetëm udhëzues dhe pa garanci ligjore dhe institucionale mbiqyrëse.

Një komponent thelbësor i mekanizmave të llogaridhënies dhe përgjegjësisë të organeve publike që përdorin sisteme të IA-së në ofrimin e shërbimeve publike është rregullimi i auditimit algoritmik. Ky proces konsiston në analizimin e mënyrës se si funksionon një sistem IA, burimet e të dhënave që përdor, si dhe ndikimin që rezultatet e tij kanë mbi kategori të ndryshme të

---

<sup>7</sup> Shih nenin 9, Council of Europe. (2024). *Framework Convention on Artificial Intelligence, Human Rights, Democracy and the Rule of Law* (CETS No. 225). <https://rm.coe.int/1680afae3c>

<sup>8</sup> Ibid., neni 15

qytetarëve. Aneksi VII i Aktit Evropian të Inteligjencës Artificiale parashikon se auditimi duhet të jetë detyrim periodik për çdo sistem me rrezik të lartë, veçanërisht kur përdoret në vendimmarrje dhe prek aksesin në shërbime publike, ndihma ekonomike apo drejtësi. Auditimi algoritmik, në kontekstin shqiptar, duhet të kryhet nga subjekte të pavarura, jo nga vetë institucionet që përdorin teknologjinë, për të garantuar paanshmërinë dhe shmangien e konfliktit të interesit.

Gjithashtu, në vitin 2024, BE miratoi Aktin për Inteligjencën Artificiale (*the AI Act*). Kjo rregullore cilësohet si një kornizë e plotë ligjore për rregullimin e inteligjencës artificiale në të gjithë vendet e BE-së. Akti paraqet një sistem klasifikimi të bazuar në rreziqet që aplikimet e inteligjencës artificiale mund të shkaktojnë. Sistemet me rrezik të lartë, si ato që përdoren në zbatimin e ligjit, kujdesin shëndetësor dhe infrastrukturat kritike, duhet t'i nënshtrohen standardeve të rrepta të llogaridhënies, transparencës dhe mbikëqyrjes njerëzore.<sup>9</sup> Kjo rregullore përcakton përgjegjësinë për krijimin dhe zbatimin e procedurave të nevojshme për vlerësimin, caktimin dhe njoftimin e organeve të vlerësimit të përputhshmërisë, si dhe për mbikëqyrjen e sistemeve të IA-së nga organet përgjegjëse (autoritet kombëtar përgjegjës) të çdo shteti anetar.<sup>10</sup> Në të njëjtën linjë si BE, Shqipëria ka marrë nisma të rëndësishme për futjen e shërbimeve publike të digjitalizuara të inteligjencës artificiale me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike, luftimin e korrupsionit dhe përdorimin e mjeteve efektive për rritjen e efikasitetit institucional.<sup>11</sup> Gjithashtu, Kodi i Procedurave Administrative parashikon ndër të tjera, mjetet e komunikimit elektronik si një nga format e shërbimeve publike nga organet publike.<sup>12</sup> Automatizimi i shërbimeve publike nëpërmjet portalit qeveritar *e-albania* garantohet nga neni 2 i ligjit për 'Qeverisjen Elektronike' i cili përcakton detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private të ofrimit të shërbimeve elektronike dhe përdorimit të sistemeve inteligjente dhe rrjeteve të informacionit.<sup>13</sup>

Në këtë kuadër, shteti shqiptar në çdo iniciativë ligjore ose institucionale mbi krijimin e sistemeve të ofrimit të shërbimeve publike nëpërmjet IA-së duhet të bazohet në të njëjtat parime themelore: proporcionalitet, transparencë, siguri, etikë dhe respektim i të drejtave themelore të njeriut. Kuadri regullator aktual shqiptar ende nuk ka arritur këtë nivel koherence dhe përputhshmërie pasi aktet ekzistuese trajtojnë përdorimin e sistemeve të IA-së, kryesisht si aspekt teknik të digjitalizimit, pa reflektuar dimensionin etik dhe regullator që kërkon BE. Shqipëria si vend kandidat duhet të përafrojë Aktin e IA-së të BE-së dhe ratifikojë me urgjencë Konventën

---

<sup>9</sup> Mazelliu, A., Mitllari, L. (Burnazi), & Methasani Çani, E. (2026). Human rights risks in AI regulation: A comparative study of Italy and Albania. *The Italian Law Journal (ItaLJ)*. [Forthcoming]

<sup>10</sup> Neni 28 & 70 i Regulation (EU) 2024/1689 of the European Parliament and of the Council laying down harmonised rules on artificial intelligence and amending Regulations (EC) No 300/2008, (EU) No 167/2013, (EU) No 168/2013, (EU) 2018/858, (EU) 2018/1139 and (EU) 2019/2144 and Directives 2014/90/EU, (EU) 2016/797 and (EU) 2020/1828 (Artificial Intelligence Act). Official Journal of the European Union.

<sup>11</sup> Kamberi, G. (2021). *Inovacioni në administratën dhe shërbimet publike në Shqipëri: "Maratona" që sapo ka nisur*. Friedrich-Ebert-Stiftung.

<sup>12</sup> LIGJ Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë

<sup>13</sup> Shih neni 2 dhe 3 të Ligjit 40/2023 për Qeverisjen Elektronike

kuadër të Këshillit të Evropës mbi Inteligjencën Artificiale, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës<sup>14</sup>, të miratuar në vitin 2024. Qendra e IA-së dhe Politikave digjitale është një rrjet botëror i eksperteve të IA-së dhe të drejtave të njeriut, që i kanë bërë thirrje qeverisë shqiptare për të ratifikuar këtë konvente si një garanci për sigurimin e përdorimit të inteligjencës artificiale në përputhje me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.<sup>15</sup>

Mungesa e një kuadri të qartë rregullator në Shqipëri ka bërë që përdorimi i teknologjive inteligjente të mbetet i pa dokumentuar dhe i paverifikueshëm, duke krijuar perceptimin e mungesës së përgjegjësisë institucionale dhe cënim të të drejtave të subjekteve të cilët janë subjekt i vendimarrjeve ku sistemet IA janë pjesë integrale e procesit. Për këtë arsye, kuadri ligjor që duhet të miratohet duhet të parashikojë detyrimin për raportim periodik nga çdo institucion publik që përdor IA, në të cilin përfshihen të dhënat mbi auditimet, testimet për diskriminim dhe ndërhyrjet korrigjuese të realizuara. Gjithashtu llogaridhënia në përdorimin e IA-së nuk mund të kufizohet vetëm në nivel institucional, por duhet të shtrihet edhe në nivel qytetar, duke garantuar mekanizma efektive ankimi dhe rishikimi të vendimeve të automatizuara. Ky mekanizëm ankimi duhet të institucionalizohet përmes një strukture të posaçme brenda institucioneve, ku çdo qytetar do të mund të parashtrijë ankesa për vendime të automatizuara që i duken të padrejta, të pasakta ose diskriminuese dhe duhet të ndikojë në llogaridhënien dhe përgjegjësinë e organit publik përgjegjës si në rastet e subjekteve juridike apo individëve. Kjo do të forconte besimin publik në drejtësinë digjitale dhe do të sillte një kulturë të re të kontrollit qytetar ndaj teknologjisë. Megjithatë, ndërtimi i mekanizmave formale nuk është i mjaftueshëm nëse mungon kultura institucionale e llogaridhënies. Qeveritë duhet të ndërtojnë një kulturë të përhershme të etikës teknologjike, një mënyrë të të menduarit që e sheh çdo përdorim të IA-së si akt moral, jo vetëm teknik. Kjo kërkon që çdo vendim për zbatimin e një sistemi të ri IA të shoqërohet me pyetjen: “*Kush mban përgjegjësi nëse ky sistem gabon?*”.

### III. Përgjegjësia e vendimarrjes automatike

#### 1. Kuadri ligjor shqiptar dhe vendimarrja automatike

Shqipëria konsiderohet një nga vendet e Ballkanit Perëndimor që ka integruar teknologjinë e shërbimeve publike në kohë rekord.<sup>16</sup> Aktualisht vendi ynë ka një nivel të ulët financimi si nga qeveria ashtu edhe nga sektori privat për iniciativat që lidhen me IA, që pengon inovacionin në shkallë të gjerë dhe përdorimin masiv të teknologjive të IA-së.<sup>17</sup> Sistemet IA e bëjnë automatizimin më inteligjent duke lehtësuar vendimarrjen, bazuar në të dhëna historike ose inpute në kohë reale.

---

<sup>14</sup> Council of Europe. (2024). *Framework Convention on Artificial Intelligence, Human Rights, Democracy and the Rule of Law* (CETS No. 225). <https://rm.coe.int/1680afae3c>

<sup>15</sup> Center for AI and Digital Policy. June 2025. A Call to Albania to Sign and Ratify the International Treaty on AI, Human Rights, Democracy, and the Rule of Law

<sup>16</sup> Kokalari, A., & Yeung, T. The unexpected AI unicorn in Europe: Albania. College of Europe. <https://www.coleurope.eu/unexpected-ai-unicorn-europe-albania>

<sup>17</sup> Çani, E. M., Çuka, M., & Mazelliu, A. Transparency and Accountability in AI Systems: A Realistic Approach in Albania. In *Artificial Intelligence in Legal Systems* (pp. 50-62). Chapman and Hall/CRC.

Aktet normative për përdorimin e sistemeve inteligjente dhe ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet sistemeve IA duhet të parashikojnë marrjen e vendimeve administrative në mënyrë automatike, por nuk zhveshin punonjësit publik nga përgjegjësia administrative. Kodi i Procedurave Administrative aktual<sup>18</sup> rregullon ofrimin e shërbimeve publike kryesisht në mënyrë *offline*, duke kërkuar bashkëveprim të drejtpërdrejtë midis institucioneve dhe palëve të interesuara.<sup>19</sup> Këto dispozita krijojnë një boshllëk administrativ në rregullimin e ofrimit të shërbimeve përmes sistemeve të IA-së. Megjithatë, parimet e këtij Kodi, mbeten të zbatueshme edhe në mjedisin digjital, ku organi publik, i cili është duke e ofruar shërbimin mbetet përgjegjës edhe kur nuk ekziston komunikim fizik me subjektin e interesuar. Në këtë kontekst, mënyra e përdorimit të sistemeve të IA-së i lihet në diskrecion ligjvënësit ose qeverisë për rregullime të mëtejshme që lidhen me vendimmarrjen.<sup>20</sup>

Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”<sup>21</sup>, i ndryshuar, parashikon për herë të parë një përkufizim të inteligjencës artificiale duke e konsideruar si simulim të proceseve të inteligjencës njerëzore përmes algoritmeve kompjuterike.<sup>22</sup> Megjithatë, ky ligj nuk vendos standarde të qarta mbi transparencën, kontrollin njerëzor dhe procedurat e ankimit për vendimet e automatizuara. Gjithashtu, ligji parashikon se autoritetet publike dhe subjektet private janë përgjegjëse për ofrimin dhe realizimin e shërbimit publike në rrugë elektronike përmes në portalitn “e-Albania”.<sup>23</sup> Bazuar në nenin 22 të këtij ligji, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është autoriteti përgjegjës për qeverisjen elektronike, për infrastrukturën qendrore të shërbimeve elektronike dhe ofrimin e shërbimeve elektronike të përqëndruara.<sup>24</sup> AKSHI është institucioni përgjegjës që ofron shërbimet e autentifikimit, nënshkrimit elektronik, vulës elektronike dhe certifikatës elektronike për organet dhe institucionet e administratës publike dhe subjektet private por nuk është autoriteti përgjegjës për pasojat administrative që mund të sjellë akti administrativ. Autoritetet publike dhe subjektet private të ofrimit të shërbimeve nëpërmjet portalit e-albania, janë përgjegjëse për pasojat administrative të vendimmarrjes.<sup>25</sup>

Vendimi i Këshillit të Ministrave i vitit 2024 “Për miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardeve teknike për përdorimin e AI në Shqipëri” është dokumenti i vetëm që rregullon përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale në Shqipëri<sup>26</sup> është i miratuar me një proces të përshpejtuar dhe pa konsultim publik. Ky dokument strategjik parashikon standardet dhe parimet mbi proceset dhe procedurat që lidhen me përcaktimin, rregullimin dhe menaxhimin e rreziqeve

---

<sup>18</sup> Ligji 44/2015 Kod i Procedurave Administrative i Republikës Së Shqipërisë

<sup>19</sup> Neni 10 i LIGJ Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë

<sup>20</sup> Neni 15 & 43 i LIGJ Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë

<sup>21</sup> Ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, i ndryshuar.

<sup>22</sup> Ibid., neni 4, para 16.

<sup>23</sup> Ligji 43/2023 për Qeverisjen Elektronike.

<sup>24</sup> Shih nenin 22 të Ligjit Nr. 43/2023 Për Qeverisjen Elektronike

<sup>25</sup> Shih Nenin 11 të Ligjit Nr. 43/2023 Për Qeverisjen Elektronike

<sup>26</sup> *Vendimi nr. 370 i Këshillit të Ministrave, datë 1.6.2022, për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe të Planit të Veprimit 2022–2026.* Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë.

të IA-së. Ky vendim parashikon në mënyrë të përgjithshme se përdorimi i sistemeve të IA-së do të bazohet në parimin e përgjegjshmërisë ku parashikohet se: *“Institucionet publike, organizatat, bizneset dhe individët që zhvillojnë, zbatojnë ose operojnë sisteme të IA-së duhet të mbajnë përgjegjësi për funksionimin e tyre të duhur në përputhje me parimet e kësaj metodologjie, bazën ligjore përkatëse dhe vlerat njerëzore e shoqërore.”*<sup>27</sup>

Sipas këtij vendimi, subjektet të cilat ofrojnë përdorimin e sistemeve të IA-së duhet të garantojnë dokumentacionin e plotë dhe nevojshëm mbi vendimet kyçe të ciklit të sistemeve të IA-së.<sup>28</sup> Ky vendim nuk ka parashikim ligjor në lidhje me përgjegjësinë njerëzore apo sanksione lidhur me llogaridhënien, por parashikohet se përgjegjësia njerëzore është e pashmangshme në lidhje me llogaridhënien përfundimtare që institucionet kanë kur përdorin sistemet e IA-së. Gjithashtu, vendimi parashikon detyrime konkrete për institucionet publike për të garantuar transparencë në fazën e ndërveprimit të qytetarëve me sistemin e IA-së, por nuk qartëson mënyrën dhe mekanizmat e sigurimit të transparencës. Si rrjedhojë, organet publike që përdorin këto sisteme kanë diskrecion në mënyrën e garantimit të transparencës dhe llogaridhënies duke parashikuar qartësisht përgjegjësinë dhe duke bere publike dokumentacionin e plotë të ciklit IA për vendimmarrjen.

Sektorët më të prekur nga përdorimi i sistemeve të IA-së janë ato që kanë lidhje me ofrimin e shërbimeve bazë për qytetarët, si portali qeveritar e-Albania, shërbimet shëndetësore, sistemet e përfitimeve sociale, punësimi, arsimit dhe drejtësia. Përdorimi i IA-së në këto fusha mund të rrisë eficientë administrative, por gjithashtu paraqet rreziqe serioze për të drejtat themelore të qytetarëve. Për shembull, në fushën e drejtësisë përdorimi i mjeteve të analizës automatike të dokumenteve apo të parashikimit të sjelljeve kriminale pa analizën e gjyqtarëve dhe prokurorëve apo profesionistëve të tjerë të sistemit të drejtësisë, si dhe pa mbikëqyrje ligjore të përshtatshme mund të cenojë parimin e procesit të rregullt ligjor dhe barazinë para ligjit.

Transparenca dhe llogaridhënia mbeten ndër sfidat më të mëdha të sistemeve të inteligjencës artificiale në vendin tonë. Kuadri ligjor aktual nuk garanton një detyrim të qartë për informimin e qytetarëve nëse një vendim merret nga një sistem i Inteligjencës Artificiale, që bie ndesh me parimin e të drejtës për shpjegim të parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR)<sup>29</sup> si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së<sup>30</sup>. Rasti i rrjedhjes së të dhënave personale në vitin 2021, ku mbi 910,000 të dhëna sensitive të qytetarëve u ekspozuan publikisht, tregon rreziqet e mungesës së kontrolleve efektive dhe shmangien nga përgjegjësia e

---

<sup>27</sup> Ibid.

<sup>28</sup> Parimi 1.5, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 24.7.2024, për miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.

<sup>29</sup> Regulation (EU) 2016/679 (GDPR), nenet 13(2)(f), 14(2)(g), 15(1)(h) dhe 22; Recital 71. Shih linkun e tekstit zyrtar: [eur-lex.europa.eu](http://eur-lex.europa.eu)

<sup>30</sup> CJEU, Case C-203/22, 27 shkurt 2025 – mbi shpjegueshmërinë e vendimeve të automatizuara. Shih linkun e gjykatës: [curia.europa.eu](http://curia.europa.eu)

institucioneve kompetente.<sup>31</sup> Po kështu, sulmet kibernetike të vitit 2022–2023, të cilat paralizuan përkohësisht sisteme qeveritare dhe databaza shtetërore, nxjerrin në pah dobësitë e legjislacionit shqiptar për sigurinë kibernetike dhe nevojën për mekanizma më të fortë të mbrojtjes së infrastrukturës së tyre<sup>32</sup>.

Një mangësi thelbësore në kuadrin shqiptar është krijimi i një autoriteti të posaçëm të pavarur për mbikëqyrjen e sistemeve të IA-së. Aktualisht, kompetencat janë të shpërndara midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por asnjë prej këtyre institucioneve nuk ka kapacitetet dhe mandatin e plotë për të audituar sistemet e IA-së apo për të vendosur sanksione specifike. Në këtë drejtim, modelet e Italisë<sup>33</sup> dhe Spanjës<sup>34</sup>, që kanë krijuar regjistra kombëtarë të sistemeve të IA-së dhe struktura të posaçme mbikëqyrëse, paraqesin praktika të mira për t'u ndjekur. Garancitë procedurale janë një tjetër fushë problematike që kërkon vëmendje. Kodi i Procedurave Administrative përcakton parimin e ndihmës aktive për qytetarët dhe të drejtën për ankim, por nuk përmban dispozita specifike për vendimet e automatizuara. Në mungesë të një ligji të posaçëm për IA, qytetarët përballen me vështirësi për të kërkuar shpjegim, për të provuar diskriminimin algoritmik apo për të siguruar rishikim njerëzor të vendimeve të sistemeve të automatizuara.

## IV. Kufizimet ligjore të përdorimit të inteligjencës artificiale

### 1. Sektorët e prekur nga automatizimi algoritmik dhe teknologjia

Ofrimi i shërbimeve publike në Shqipëri nëpërmjet sistemeve inteligjente realizohet përmes portalit e-Albania, i cili ka zëvendësuar pjesën më të madhe të procedurave fizike me aplikime online, duke integruar sisteme të bazuara në algoritme për verifikimin e të dhënave, ndërveprimin ndërinstitucional dhe gjenerimin automatik të dokumenteve administrative<sup>35</sup>. Pavarësisht se kjo ka sjellë rritje të eficiencës dhe reduktim të burokracisë, ajo krijon rrezik për pabarazi digjitale (p.sh., qytetarët pa aftësi teknologjike, personat me aftësi të kufizuara apo pa akses interneti mbeten të përjashtuar).<sup>36</sup> Për më tepër, mungesa e transparencës mbi mënyrën si funksionojnë algoritmet e brendshme e bën të vështirë që qytetarët të kuptojnë kriteret mbi të cilat jepet apo refuzohet një shërbim publik.

---

<sup>31</sup> Exit Explains: The Leak of Over 910,000 Albanians Personal Data to Politicians and the Public. Aksesuar nga: <https://exit.al/en/2021/04/16/exit-explains-the-leak-of-over-910000-albanians-personal-data-to-politicians/>

<sup>32</sup> FBI & CISA Iranian State Actors Conduct Cyber Operations Against the Government of Albania. Aksesuar nga: <https://www.ic3.gov/CSA/2022/220921.pdf>

<sup>33</sup> Cooper, D., & Somaini, L. (2024, May 30). *Italy proposes new artificial intelligence law*; <https://www.insideprivacy.com/artificial-intelligence/italy-proposes-new-artificial-intelligence-law/>

<sup>34</sup> GDPR Local, *Spain's AEPD steps up supervision of AI systems ahead...* (16 July 2025 <https://gdprlocal.com/aepd-ai-act/>; European Commission, *AI Watch – Spain AI Strategy Report* [https://ai-watch.ec.europa.eu/countries/spain/spain-ai-strategy-report\\_en](https://ai-watch.ec.europa.eu/countries/spain/spain-ai-strategy-report_en).

<sup>35</sup> The World Bank. *Inclusive and User-Centred Services in Albania*.

<sup>36</sup> Kaso, J. (2025, April 25). *Digital divide: The Albanians left behind by move to online public services*. Balkan Investigative Reporting Network (BIRN).

Algoritmet po përdoren gjithnjë e më shumë edhe në sektorin e shëndetësisë duke filluar nga analizat e të dhënave epidemiologjike deri tek ndihma klinike (p.sh., radiologjia e asistuar nga IA)<sup>37</sup>. Në Shqipëri ka nisur të përdoret trajtimi automatik dhe parashikimi i prirjeve të pacientëve për sëmundje të caktuara, por kjo sjell një problem të dyfishtë: cilësinë e dataset-eve (të dhënat shëndetësore shpesh janë të fragmentuara dhe jo të standardizuara) dhe mbrojtjen e privatësisë (rreziku i rrjedhjes së të dhënave mjekësore është shumë i lartë).<sup>38</sup> Nëse sistemet IA përdoren për vendime që ndikojnë në trajtimin, prioritetin ose përfitimet e pacientit pa ndërhyrje njerëzore, atëherë mund të cenohet e drejta për kujdes shëndetësor të barabartë dhe parimi i mosdiskriminimit.

Një nga fushat më delikate është përdorimi i IA-së në skemat e ndihmës ekonomike, sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve të tjera sociale. Administrata publike po teston mënyra për të përdorur algoritme që zvogëlojnë rrezikun e abuzimit apo që kategorizojnë përfituesit sipas kriterëve të caktuara. Megjithatë, ky proces mbart rrezikun e diskriminimit algoritmik, nëse modelet trajnohen nga të dhëna historike të mbushura me paragjykime (p.sh., në bazë të gjinisë, zonës së banimit apo statusit socio-ekonomik).<sup>39</sup> Në mungesë të mekanizmave të qartë për transparencë dhe për testim të paragjykimeve, qytetarët që preken nga një vendim i tillë e kanë të vështirë të kuptojnë arsyet dhe të gjejnë mjete efektive për ankim.<sup>40</sup>

Algoritmet po gjejnë përdorim edhe në punësimin publik, përmes sistemeve të rekrutimit të automatizuar, filtrimit të jetëshkrimit personal dhe testimit online. Kjo praktikë rrit rrezikun e seleksionimit jo transparent, ku kandidati mund të refuzohet automatikisht nga një sistem pa mundësi për të kërkuar shpjegim.<sup>41</sup> Në sektorin e arsimit, përdorimi i IA-së në mësimdhënie apo në vlerësimin e nxënësve mund të ndikojë në pyetje dhe përgjigje që ndikojnë në besueshmërinë e rezultateve të prodhuara. Ky është një sektor që, sipas Aktit të BE-së për IA, konsiderohet 'me rrezik të lartë' dhe kërkon monitorim të vazhdueshëm.<sup>42</sup>

Përdorimi i IA-së në sistemin gjyqësor dhe në sistemin e policisë është ende në fazë eksperimentale, por tendencat janë të qarta. Në drejtësi, përdorimi i sistemeve të IA-së mund të

---

<sup>37</sup> Perolla, A., Demiraj, A., & Spada, V. (2023). *Artificial intelligence in medicine: Are we ready for this challenge? A literature review. AJMHS*, 63.

<sup>38</sup> Hoxha, S. B., Bushi, F., & Gjecka, A. (2024). Application & Challenges Of Big Data Technologies In Albanian Health Care System. *Interdisciplinary Journal of Research and Development*, 11(3), 120-120.

<sup>39</sup> Saar Alon-Barkat, Madalina Busuioc, Kayla Schwoerer, Kristina S Weißmüller, Algorithmic discrimination in public service provision: Understanding citizens' attribution of responsibility for human versus algorithmic discriminatory outcomes, *Journal of Public Administration Research and Theory*, Volume 35, Issue 4, October 2025, Pages 469–488, <https://doi.org/10.1093/jopart/muaf024>

<sup>40</sup> GPAI (2024). "Algorithmic Transparency in the Public Sector: A state-of-the-art report of algorithmic transparency instruments". Report, May 2024, Global Partnership on Artificial Intelligence

<sup>41</sup> Larsson, S., White, J. M., & Ingram Bogusz, C. (2024). The Artificial Recruiter: Risks of Discrimination in Employers' Use of AI and Automated Decision-Making. *Social Inclusion*, 12., Rigotti, C., & Fosch-Villaronga, E. (2024). Fairness, AI & recruitment. *Computer Law & Security Review*, 53, 105966.

<sup>42</sup> Recital 56, EU AI Act. Aksesuar nga: <https://ai-act-law.eu/recital/56/>

ndihmojë në analizën e vendimeve gjyqësore ose në menaxhimin e dosjeve, ndërsa në polici<sup>43</sup> është përdorur për analizë të krimeve si dhe në parashikimin e sjelljeve kriminale. Këto aplikime bartin rrezikun e cenimit të procesit të rregullt ligjor dhe të drejtës për gjykim të paanshëm, nëse vendimet automatizohen pa kontroll njerëzor. Në zbatimin e ligjit, përdorimi i mjeteve biometrike dhe të identifikimit nëpërmjet fytyrës (*facial recognition*) ndikon te shkelja e privatësisë, identitetit dhe liria e lëvizjes.<sup>44</sup> Një tjetër sektor i prekur është prokurimi publik, ku IA përdoret për të identifikuar parregullsi, për të minimizuar rrezikun e korrupsionit dhe për të shmangur konfliktin e interesit. Këto janë praktika pozitive në parim, por në mungesë të rregullave të forta mbi auditimin, ekziston rreziku që algoritmet të kthehen në mjete të paqarta që legjitimojnë vendime të mbyllura, duke cenuar transparencën dhe konkurrencën e drejtë.<sup>45</sup>

## 2. Transparenca dhe llogaridhënia administrative

Përdorimi i inteligjencës artificiale në organet publike ndikon në përmirësimin e cilësisë së politikave dhe shërbimeve, por njëkohësisht krijon rreziqe substanciale për të drejtat dhe liritë themelore nëse mungon transparenca, llogaridhënia dhe nuk zbatohen mekanizmat e duhur të garantimit të të drejtave. Kuadri evropian ka parashikuar se shumë sisteme të IA-së të përdorura nga organet publike kategorizohen si sisteme me rrezik të lartë dhe, para përdorimit paraprak, kërkohet një vlerësim i pavarur dhe i dokumentuar për ndikimin mbi të drejtat themelore.<sup>46</sup>

Transparenca në këtë kontekst nuk reduktohet në publikimin e përgjithshëm të një dokumenti politikash: ajo presupozon shpjegime konkrete dhe të mjaftueshme për të kuptuar logjikën e funksionimit, kriteret e vendimmarrjes, burimet e të dhënave dhe kufizimet e modelit; gjurmueshmëri teknike që lejon rindërtimin e hapave të një vendimi konkret dhe akses efektiv të palëve të interesuara në dokumentacionin thelbësor. Kjo qasje është në përputhje me Parimet e OECD-së për IA (2019)<sup>47</sup>, të cilat kërkojnë përdorim të besueshëm e të shpjegueshëm të IA-së, si dhe me Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për IA, e cila vendos si standard faktin që aktivitetet përgjatë gjithë ciklit të jetës së sistemeve të IA-së të jenë në përputhje me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

Llogaridhënia kërkon identifikim të qartë të aktorëve përgjegjës, ofruesve që projektojnë sistemin, subjektet (deployer) që e përdorin në procesin administrativ, si dhe zyrtarët publikë që marrin ose konfirmojnë aktin administrativ. Në praktikë, kjo nënkupton se kontratat publike për

---

<sup>43</sup> Europol (2023), *The Second Quantum Revolution – The impact of quantum computing and quantum technologies on law enforcement*, Europol Innovation Lab observatory report, Publications Office of the European Union, Luxembourg.

<sup>44</sup> Gültekin-Várkonyi, G. (2024). Navigating data governance risks: Facial recognition in law enforcement under EU legislation. *Internet Policy Review*, 13(3). <https://doi.org/10.14763/2024.3.1798>

<sup>45</sup> OECD (2025), *Governing with Artificial Intelligence: The State of Play and Way Forward in Core Government Functions*, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/795de142->

<sup>46</sup> Regulation (EU) 2024/1689 of the European Parliament and of the Council laying down harmonised rules on artificial intelligence and amending Regulations (EC) No 300/2008, (EU) No 167/2013, (EU) No 168/2013, (EU) 2018/858, (EU) 2018/1139 and (EU) 2019/2144 and Directives 2014/90/EU, (EU) 2016/797 and (EU) 2020/1828 (Artificial Intelligence Act). Official Journal of the European Union.

<sup>47</sup> OECD. AI Principles. Aksesuar nga: <https://www.oecd.org/en/topics/sub-issues/ai-principles.html>

blerjen ose zhvillimin e sistemeve të IA-së duhet të parashikojnë të drejta auditimi, akses në regjistrat teknikë, dorëzimin e dokumentacionit të shpjegueshmërisë dhe detyrimin për korrigjim kur konstatohet devijim ose paragjykim algoritmik. Po aq me rëndësi, organet e kontrollit (p.sh. auditimi i jashtëm, organet ankimore, autoriteti i të dhënave, gjykatat) duhet të kenë një bazë të mjaftueshme ligjore dhe kapacitete teknike për të inspektuar modelet dhe të dhënat, përndryshe llogaridhënia mbetet formale. Praktikrat e mira të OECD-së theksojnë pikërisht këtë lidhje organike midis transparencës teknike dhe llogaridhënies materiale.<sup>48</sup>

Kuadri rregullator shqiptar në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien rrezikon të mbetet i pamjaftueshëm në praktikë nëse nuk ndërmerren hapa konkrete për miratimin e rregulloreve dhe udhëzimeve sektoriale që parashikojnë masa konkrete për zbatimin e tyre. Sikundër u parashikua më lart, problematikat në lidhje me rrjedhjet masive të të dhënave personale në vitin 2021, si dhe sulmet kibernetike të vitit 2022 kundër sistemeve shtetërore, dëshmojnë se mungesa e kontrolleve teknike dhe organizative sjell pasojat të drejtpërdrejta për privatësinë, sigurinë dhe besimin publik. Nëse mbi këtë infrastrukturë të cenueshme ndërtohen funksione të reja të inteligjencës artificiale, rreziku shumëfishohet: çdo klasifikim ose vendim i automatizuar mbështetet mbi të dhëna potencialisht të kompromentuara, ndërsa mungesa e auditimit e bën të vështirë rikthimin e gjendjes në rast abuzimi. Kjo kërkon që masat e transparencës dhe llogaridhënies të kombinohen me kërkesa të rrepta të sigurisë kibernetike dhe integritetit të të dhënave si parakusht për përdorimin e IA-së. Një fenomen që shkaktoi debat në lidhje me legjitimitetin e kësaj vendimmarrje, ishte emërimi në shtator të vitit 2025, nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë i ‘ministres’ së parë virtuale në botë e quajtur “Diella”. Kjo ‘ministre’ e inteligjencës artificiale ka fushë përgjegjësie digjitalizimin 100% të prokurimeve publike me qëllim luftën ndaj korrupsionit.<sup>49</sup> Dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë për emërimin e Kryeministrit, në nenin 2 të tij, parashikon se ky i fundit ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual të inteligjencës artificiale “Diella”.

Megjithatë çështje që mbeten të paqarta lidhen me legjitimitetin e Ministres dhe nëse ky veprim është kushtetues përse i përket garancive të saj në emërimin si një funksionar publik, një prodhim i sistemeve të inteligjencës artificiale.<sup>50</sup> Studiuesit kanë analizuar se ministria virtuale “Diella”<sup>51</sup> mund të ketë probleme që lidhen me garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë në ushtrimin e funksioneve. Nisma është novatore, por ka mungesë të parashikimeve ligjore konkrete si në kudrin kushtetues dhe administrativ. Madje ekzistenca e një ministri virtual përbën shkak për shkelje të Kushtetutës dhe mungesës së përgjegjësisë që ka çdo ministër në ushtrimin e kompetencave të veta.<sup>52</sup> Kushtetua nuk le ekuivoke, pasi përgjegjësia ligjore dhe kushtetuese i

---

<sup>48</sup> Shih linkun: [https://www.oecd.org/en/publications/2025/06/governing-with-artificial-intelligence\\_398fa287/full-report/ai-in-public-procurement\\_2e095543.html](https://www.oecd.org/en/publications/2025/06/governing-with-artificial-intelligence_398fa287/full-report/ai-in-public-procurement_2e095543.html)

<sup>49</sup> Maciel Perez, L., & Démas, M. (2025). The human crisis of AI exceptionalism: The case of Diella, Albania’s “AI minister”. Aksesuar nga: <https://emildai.eu/the-human-crisis-of-ai-exceptionalism-the-case-of-diella-albanias-ai-minister/>

<sup>50</sup> Dekreti i Presidentit nr. 331, date 12.09. 2025 për Emërimin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

<sup>51</sup> <https://www.kryeministria.al/ministrat/diella/>

<sup>52</sup> Neni 103 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

vishet nje shtetasi shqiptar qe plotëson kriteret ligjore për ushtrimin e funksionit publik dhe jo një krijese imagjinare të krijuar nga sistemet inteligjente.<sup>53</sup> Shqipëria apo shtete të tjera mund të kenë një Ministri të IA-së, por kuresesi nuk mund të kemi një Ministër. Gjithsesi, shteti shqiptar duhet të mbajë në konsideratë që për ngritjen dhe funksionimin e Ministrisë Virtual të Inteligjencës Artificiale “Diella”, kërkon rregullim të qartë ligjor, veçanërisht në lidhje me mënyrën e vendimmarrjes, e cila duhet të jetë e përcaktuar, transparente dhe publike,. Po ashtu, është thelbësore që çdo vendimarrje algoritmike e pasaktë, e padrejtë apo e bazuar në të dhëna të pasakta ose të falsifikuara të jetë e ankimeshme dhe të jetë qartësisht i identifikueshëm subjekti që mban përgjegjësinë ligjore për pasojat e saj.<sup>54</sup>

## V. Konkluzione dhe Rekomandime

Analiza tregon se Shqipëria ndodhet në një fazë vendimtare të transformimit digjital të shërbimeve publike, ku përdorimi i inteligjencës artificiale po rritet me ritme të shpejta, ndërsa kuadri ligjor dhe institucional për garantimin e të drejtave themelore, transparencës dhe llogaridhënies mbetet i pamjaftueshëm. Ky hendek rregullator rrit rrezikun e vendimmarrjes së paqartë, të paverifikueshme dhe potencialisht diskriminuese, veçanërisht në sektorë me ndikim të drejtpërdrejtë të qytetarët.

Nga analiza e mësipërme, si dhe nga përvoja e Shqipërisë dhe e vendeve të tjera, rezultojnë se inteligjenca artificiale po transformon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike, duke sjellë përfitime të konsiderueshme në eficiencë dhe akses, por edhe sfida serioze ligjore, etike dhe institucionale. Në këtë kontekst, shteti shqiptar duhet të ndërmarrë masa të qëndrueshme dhe të strukturuar për të adresuar rreziqet që lidhen me përdorimin e sistemeve të IA-së, veçanërisht kur ato ndikojnë në të drejtat dhe interesat e qytetarëve. Kuadri aktual ligjor për përdorimin e IA-ve në ofrimin e shërbimeve publike mbetet i fragmentuar dhe kryesisht orientues. Aktet ekzistuese nuk sigurojnë mekanizma detyrues për mbikëqyrje, auditim algoritmik, transparencë dhe rishikim njerëzor të vendimeve të automatizuara, duke e lënë përgjegjësinë institucionale të paqartë. Kjo situatë bie ndesh me qasjen evropiane, e cila e trajton inteligjencën artificiale si çështje thelbësore për demokracinë, shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave themelore.

Procesi i integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian kërkon miratimin e një kuadri të plotë dhe koherent rregullator për inteligjencën artificiale, në përputhje me *acquis communautaire*. Në këtë drejtim, Strategjia Kombëtare e Inteligjencës Artificiale, e cila pritet të miratohet, përfaqëson një shprehje të rëndësishme të vullnetit politik për përafrimin e legjislacionit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, por ajo duhet të shoqërohet me masa konkrete ligjore dhe mekanizma detyrues zbatimi.

---

<sup>53</sup> Kryeziu, E. (2025, September 22). Diella, the virtual assistant who “became a minister”: Reality or spectacle? Citizens. Aksesuar nga: <https://citizens.al/en/2025/09/22/diella-asistentja-virtuale-qe-u-be-ministre-realitete-apo-spektakel/>

<sup>54</sup> Winslow-Stephenson, Walker: Accession by Algorithm: Albania’s Experiment with Algorithmic Governance and EU Accession, VerfBlog, 2026/1/21, <https://verfassungsblog.de/albania-ai-eu/>, DOI: 10.59704/b0c2bfca91524ea8.

Si konkluzion,, kuadri ligjor shqiptar për përdorimin e IA-së paraqet disa mangësi të qarta të cilat lidhen me mungesën e një ligji të posaçëm dhe të një autoriteti mbikëqyrës, standarde të paqarta për transparencën dhe kontrollin njerëzor, si dhe dobësi të theksuara në sigurinë e të dhënave dhe të infrastrukturës. Për t'u harmonizuar me *acquis communautaire* të BE-së dhe me Konventën e Këshillit të Evropës, Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa konkretë në miratimin e një legjislacioni të posaçëm për IA, krijimin e një regjistri kombëtar të sistemeve të IA-së, forcimin e kapaciteteve institucionale të mbikëqyrjes dhe vendosjen e garancive të forta procedurale për mbrojtjen e qytetarëve.

### **Rekomandime:**

1. Hartimi dhe miratimi i një kuadri rregullator të plotë për ofrimin e shërbimeve dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale nga organet publike.
2. Krijimi i mekanizmave të llogaridhënies, transparencës dhe monitorimit në ofrimin e shërbimeve dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale në organet publike, si edhe krijimin e një autoriteti të posaçëm ose një njësie mbikëqyrëse.
3. Miratimi i Draft Strategjisë Kombëtare për inteligjencën artificiale në përputhje me standardet ndërkombëtare..
4. Parandalimi i diskriminimit të algoritmit në testimin e paragjyqimeve, stereotipeve dhe krijimin e një regjistri algoritmik (Regjistër Kombëtar i Sistemeve të IA-së) ku të regjistrohen te gjitha sistemet dhe modelet e inteligjencës artificiale të përdorura.
5. Integrimi i etikës dhe të drejtave të njeriut në çdo fazë të zhvillimit dhe zbatimit të inteligjencës artificiale në shërbimet publike.
6. Detyrimin për kryerjen e Vlerësimit të Ndikimit Algoritmik për çdo sistem të inteligjencës artificiale të përdorur.
7. Trajnimi i punonjësve publikë për përdorim të përgjegjshëm të teknologjive të reja.

## Bibliografia

### Akte Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 40/2023 për Qeverisjen Elektronike

Dekreti i Presidentit nr. 331, date 12.09. 2025 për Emërimin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2022, 1 qershor). *Vendim nr. 370, datë 1.06.2026 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe të Planit të Veprimit 2022–2026.”*

Council of Europe. (2024). *Framework Convention on Artificial Intelligence, Human Rights, Democracy and the Rule of Law* (CETS No. 225). <https://rm.coe.int/1680afae3c>

Regulation (EU) 2024/1689 of the European Parliament and of the Council laying down harmonised rules on artificial intelligence and amending Regulations (EC) No 300/2008, (EU) No 167/2013, (EU) No 168/2013, (EU) 2018/858, (EU) 2018/1139 and (EU) 2019/2144 and Directives 2014/90/EU, (EU) 2016/797 and (EU) 2020/1828 (Artificial Intelligence Act). Official Journal of the European Union.

Vendimi nr. 370 i Këshillit të Ministrave, datë 1.6.2022, për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë” dhe të Planit të Veprimit 2022–2026. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 24.7.2024, për miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë.

### Literaturë

Cani, E. M., & Mazelliu, A. (2025). Navigating the Algorithmic Shift and the Legal Implications of Artificial Intelligence in Albania's Public Administration. *Italian J. Pub. L.*, 17, 496.

Çani, E. M., Çuka, M., & Mazelliu, A. Transparency and Accountability in AI Systems: A Realistic Approach in Albania. In *Artificial Intelligence in Legal Systems* (pp. 50-62). Chapman and Hall/CRC.

Center for AI and Digital Policy. June 2025. A Call to Albania to Sign and Ratify the International Treaty on AI, Human Rights, Democracy, and the Rule of Law

Charlotte Langer, “Decision-making power and responsibility in an automated administration” (2024) *Discov Artif Intell* 4, 59, available at <https://doi.org/10.1007/s44163-024-00152-1>, accessed 1 September 2024.

CJEU, Case C-203/22, 27 shkurt 2025 – mbi shpjegueshmërinë e vendimeve të automatizuara. Shih linkun e gjykatës: [curia.europa.eu](https://curia.europa.eu)

Cooper, D., & Somaini, L. (2024, May 30). *Italy proposes new artificial intelligence law*; <https://www.insideprivacy.com/artificial-intelligence/italy-proposes-new-artificial-intelligence-law/>

- Exit Explains: The Leak of Over 910,000 Albanians Personal Data to Politicians and the Public. Aksesuar nga: <https://exit.al/en/2021/04/16/exit-explains-the-leak-of-over-910000-albanians-personal-data-to-politicians/>
- European Commission, *AI Watch – Spain AI Strategy Report* [https://ai-watch.ec.europa.eu/countries/spain/spain-ai-strategy-report\\_en](https://ai-watch.ec.europa.eu/countries/spain/spain-ai-strategy-report_en).
- Europol (2023), *The Second Quantum Revolution – The impact of quantum computing and quantum technologies on law enforcement*, Europol Innovation Lab observatory report, Publications Office of the European Union, Luxembourg.
- FBI & CISA Iranian State Actors Conduct Cyber Operations Against the Government of Albania. Aksesuar nga: <https://www.ic3.gov/CSA/2022/220921.pdf>
- GDPR Local, *Spain's AEPD steps up supervision of AI systems ahead...* (16 July 2025) <https://gdprlocal.com/aepd-ai-act/>
- GPAI (2024). “Algorithmic Transparency in the Public Sector: A state-of-the-art report of algorithmic transparency instruments”. Report, May 2024, Global Partnership on Artificial Intelligence.
- Gültekin-Várkonyi, G. (2024). Navigating data governance risks: Facial recognition in law enforcement under EU legislation. *Internet Policy Review*, 13(3). <https://doi.org/10.14763/2024.3.1798>
- Hoxha, S. B., Bushi, F., & Gjecka, A. (2024). Application & Challenges Of Big Data Technologies In Albanian Health Care System. *Interdisciplinary Journal of Research and Development*, 11(3), 120-120.
- Kamberi, G. (2021). *Inovacioni në administratën dhe shërbimet publike nëe Shqipëri: "Maratona" që sapo ka nisur*. Friedrich-Ebert-Stiftung.
- Kaso, J. (2025, April 25). *Digital divide: The Albanians left behind by move to online public services*. Balkan Investigative Reporting Network (BIRN).
- Kokalari, A., & Yeung, T. The unexpected AI unicorn in Europe: Albania. College of Europe. <https://www.coleurope.eu/unexpected-ai-unicorn-europe-albania>
- Kryeziu, E. (2025, September 22). Diella, the virtual assistant who “became a minister”: Reality or spectacle? *Citizens*. Aksesuar nga: <https://citizens.al/en/2025/09/22/diella-asistentja-virtuale-ge-u-be-ministre-realitet-apo-spektakel/>
- Larsson, S., White, J. M., & Ingram Bogusz, C. (2024). The Artificial Recruiter: Risks of Discrimination in Employers' Use of AI and Automated Decision-Making. *Social Inclusion*, 12.
- Maciel Perez, L., & Démas, M. (2025). The human crisis of AI exceptionalism: The case of Diella, Albania’s “AI minister”. Aksesuar nga: <https://emildai.eu/the-human-crisis-of-ai-exceptionalism-the-case-of-diella-albanias-ai-minister/>
- Mazelliu, A., Mitllari, L. (Burnazi), & Methasani Çani, E. (2026). Human rights risks in AI regulation: A comparative study of Italy and Albania. *The Italian Law Journal (ItaLJ)*. [Forthcoming]
- OECD (2025), *Governing with Artificial Intelligence: The State of Play and Way Forward in Core Government Functions*, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/795de142->
- OECD. AI Principles. Aksesuar nga: <https://www.oecd.org/en/topics/sub-issues/ai-principles.html>
- Perolla, A., Demiraj, A., & Spada, V. (2023). *Artificial intelligence in medicine: Are we ready for this challenge? A literature review*. *AJMHS*, 63.
- Rigotti, C., & Fosch-Villaronga, E. (2024). Fairness, AI & recruitment. *Computer Law & Security Review*, 53, 105966.

Saar Alon-Barkat, Madalina Busuioc, Kayla Schwoerer, Kristina S Weißmüller, Algorithmic discrimination in public service provision: Understanding citizens' attribution of responsibility for human versus algorithmic discriminatory outcomes, *Journal of Public Administration Research and Theory*, Volume 35, Issue 4, October 2025, Pages 469–488, <https://doi.org/10.1093/jopart/maaf024>

The World Bank. Inclusive and User-Centred Services in Albania.

Winslow-Stephenson, Walker: Accession by Algorithm: Albania's Experiment with Algorithmic Governance and EU Accession, *VerfBlog*, 2026/1/21, <https://verfassungsblog.de/albania-ai-eu/>, DOI: 10.59704/b0c2bfca91524ea8.

**Linqe:**

<https://e-albania.al/Pages/Statistics/statistika.pdf>

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/864>

[https://www.oecd.org/en/publications/2025/06/governing-with-artificial-intelligence\\_398fa287/full-report/ai-in-public-procurement\\_2e095543.html](https://www.oecd.org/en/publications/2025/06/governing-with-artificial-intelligence_398fa287/full-report/ai-in-public-procurement_2e095543.html)

<https://www.kryeministria.al/ministrat/diella/>